



MESAZH: "SISTEMI YNË
NË MARRËDHËNIE
ME GJITHËSINË ËSHTË E MIRA!"



FETVA FYESE!



"EDUKONI FËMIJËT TUAJ
ME DASHURI PËR PROFETIN
MUHAMMED (A.S)"

Viti 16 - Nr. 10 (188),
Tetor, 2018

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

Të jetojmë **me dinjitetin e qenies mëkëmbës të Zotit në tokë!**

"Është koha që vlerat e besimit tonë t'i lexojmë e t'i kuptojmë si duhet, të vishemi me to, të angazhohemi për t'i përhapur në shoqëri me plot dinjitet dhe krenari, sepse në gjurmët e të parëve tanë do të ecim nëse duam të jetojmë me dinjitetin e qenies mëkëmbës të Zotit në tokë!"





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjithë ju kenë dëgjuar për termin: “gjynahet e mëdha”, në ligjërimet e ndryshme fetare, a në leximet tuaja të teksteve të ndryshme islame, që tërheqin vëmendjen e besimtarëve drejt përsosmërisë morale e fetare në jetë.

All-llahu i Madhëruar urdhëron në Kur'anin Famëlartë: “Ata që largohen prej gjynaheve të mëdha dhe prej punëve të fëlliqta, përpos ndonjë pune të imët, s’ka dyshim se Zoti yt është që gjerësisht përfshin me falje, se Ai di më së miri për ju edhe para se t’ju krijojë edhe kur filloi krijimin tuaj nga dheu, e edhe kur ishit të fshehur në barqet e nënave tuaja, pra mos lavdëroni veten, se Ai e di kush është më i ruajtur”.¹

Në tefsirin e këtij ajeti lexojmë se: “Gjynah i madh është ai veprim i gabuar, që vendos perde në mesin e robit me All-llahun e Madhëruar, ndërkohë që është transmetuar mallkimi për vepruesin e tij, ose ndëshkimi në ditën e gjykimit për praktikuesin e tij. ... Ndërsa [punët e imëta] të përmendura në këtë ajet, janë ato gjynahe, prej të cilave njeriu është penduar me sinqeritet, duke e mbyllur faqen e tyre. Prej këtu themi se çdo gjynah që ka bërë njeriu në gjendje xhahilijeti, para se të pendohet e të pajtohet me All-llahun; pastaj është penduar, konsiderohet si faqe e mbyllur dhe All-llahu i Madhëruar e fal dhe liron nga ai gjynah”.²

Vetëm duke menduar për këtë detaj të marrëdhënies me Zotin e gjithësisë; pendimin nga gjynahet dhe pranimin e teubes, kuptojmë madhëshinë e kësaj feje, nëpërmjet të cilës, All-llahu i Madhëruar na ka nxjerrë nga dëshpërimi në shpresë e optimizëm për jetën, nga errësira e gjynahut në dritën

1. Kur’ani, En-Nexhm: 32.

2. Dr. Mhammed Ratib En-Nabulsi, Tefsirun-Nabulsi, vëll. 9, f. 102.

TË JETOJMË ME DINJITETIN E QENIES MËKËMBËS TË ZOTIT NË TOKË!

e mirësjelljes, nga anarshia në jetë në organizim dhe disiplinë ndërtuese!

Dëgjoni këtë hadith kudsî, nëpërmjet të cilit Zoti i gjithësisë na drejtohet duke na thënë: “O i biri i Ademit, sado që ti do të më lutesh dhe do të shpresosh në mëshirën Time, do të të fal për gjynahet e bëra, pa më kushtuar asgjë! O i biri i Ademit, edhe sikur gjynahet e tua do të mbërrijnë në kupë të qiellit, pastaj ti do të më kërkosh falje, do të të fal, pa më kushtuar asgjë! O i biri i Ademit, sikur të më vije me gjynahe sa hapësirat e tokës, pastaj do të më takoje (në ditën e gjykimit) duke mos më bërë shirk, do të të vija me hapësirat e saj falje!”³

TË DASHUR E TË SHTRENJTË BESIMTARË,

Realitetet e sotme të jetës shqiptare janë të mbushura me propaganda të anarshisë, frikës, vrasjeve, drogës, alkoolit, bixhozit, borxheve me fajde, kamatës, pabesisë, tradhtisë, divorceve të shumta dhe aborteve, tendencave për ta marrë për dore shoqërinë drejt shthurjes idhujtare dhe islamofobisë, imoralitetit dhe papastërtisë, heqjes së perdeve të turpër dhe tharjes së ujit të fytyrës! Krejt këto fenomene janë alarme të forta për shoqërinë besimtare, për bashkësinë tonë, për komunitetet fetare dhe krejt ata që mendojnë dhe punojnë për të mirën e këtij vendi!

Shumëkush pyet se cila është zgjidhja? Ajo është shumë e lehtë, por njëkohësisht kërkon vullnet dhe angazhim nga gjithsecili prej nesh!

Fillimisht, secili nga ne dhe kushdo që e ndjen veten e tij të përfshirë në thirrjen e shenjtë: “O i biri i Ademit”, duhet të pendohet në çast, duke kërkuar falje e duke shpallur nijetin e pastër të pajtimit me Zotin dhe vullnetin e rrugëtimit drejt kërkimit të kënaqësisë së Tij në jetë. Shtimi i shprehjes: “Estagfirull-llah” është shumë i pëlqyer për ne, në mesin e porosive të shumta të Resulull-llahut (a.s.), me të cilat na drejtohet për të përsosur sjelljen dhe moralin tonë!

Pastaj, duhet të kuptojmë dhe të dimë shumë mirë se cilat janë gjynahet e mëdha, prej të cilave duhet distancuar

3. Transmetuar nga Tirmidhiu, nga Enesi (r.a.).

dhe shkëputur çdo lidhje me to, sado e vogël qoftë, për të përfutur mëshirën dhe faljen e Tij!

Nga këtu, më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj hadithin e Resulull-llahut (a.s.), kur thotë: “Distancohuni nga shtatë gjynahet shkatërrimtare: shirku, magjia, vrasja, ngrënia e pasurisë së jetimit, ngrënia e fajdeve, dezertimi në ditën e betejës dhe të akuzosh gratë e ndershme për imoralitet!”⁴

Ndërkohë, është transmetuar nga “Ibn Abbasi (r.a.), që thotë se këto gjynahe arrijnë deri në shtatëdhjetë”.⁵ Dhe, përtej hadithit të shtatë gjynaheve shkatërruese, ka transmetime të tjera që përfshijnë edhe shumë veprime të ulëta, që në këndvështrimin islam janë konsideruar si gjynahe të mëdha, si: mosrespektimi i prindërve, dëshmia e rreme, etj.

Në librin e titulluar “Gjynahet e mëdha”, Imam Dhehebiu (663-743 h.), ka grumbulluar plot 76 vepra, që konsiderohen si gjynahe të mëdha, veprimi i të cilave e ngarkon racën njerëzore me mallkim dhe humbje të mëshirës së Zotit!

Përmend, ndër të tjera: “Shirku, vrasja, magjia, lënia e namazit, ndalimi i zekatit, mosrespektimi i prindërve, ngrënia e fajdeve, ngrënia e pasurisë së jetimit, të gënjerit në emër të Resulull-llahut (a.s.), prishja e ditës së Ramazanit pa justifikim e pa tolerim, dezertimi në fushëbetejë, imoraliteti (zinaja), prijësi që mashtron popullin e tij, pirja e alkoolit edhe nëse nuk të deh, mendjemadhështia dhe vetëkënaqësia⁶, dëshmia e rreme, homoseksualizmi, akuzimi i grave të ndershme me imoralitet, padrejtësia e marrjes së pasurisë së tjetrit me mashtrime, vjedhja, plaçkitja, betimi i rremë, gënjeshtria, vetëvrasja, (që konsiderohet ndër gjynahet më të mëdha), gjyqtari i keq, përngjasimi i grave me burrat dhe anasjelltas, ngrënia e coftinës, gjakut dhe mishit

4. Transmetuar nga Bukhriu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejra (r.a.).

5. Imam Dhehebiu, El-Kebair, botimi i 7-të, Damask-Medine, 1991, f. 42.

6. Kanë thënë të moçmit tonë: “Nëse do ta mallkosh dikë, thuaj: T’hihtë vëdi n’qejf”.

të dërrit, mospastrimi pas kryerjes së nevojave personale, syfaqësia, tradhtia, të mësuarit për interesa material dhe fshehja e dijes, përmendja e bamirësisë së bërë, mohimi i përcaktimit hyjnor⁷, mallkuesi, vërtetimi i fjalëve të fallxhoreve e të ngjashëm me to, rebelimi i gruas, ai që shkëput lidhjet farefisnore, bartësi i fjalëve, vajtimi i të vdekurit dhe lëndimi i trupit me këtë rast, lëndimi i muslimanëve dhe sharja e tyre, lëndimi i eulijave të All-llahut dhe armiqësimi i tyre, sharja e sahabëve të mëdhenj, sharja e ensarëve, ai që thërret drejt shthurjes e devijimit, a shpik risi të dëmshme, ai që vjedh në peshore, pesimizmi në mëshirën e All-llahut, mosmirënjohja ndaj bamirësisë, lëndimi i fytyrës së kafshës, lënia e xhumasë, etj.”⁸

Nga sa më lart, kuptojmë madhëshinë e kësaj feje, që ka përfshirë çdo fushë të jetës, duke nxitur të mirën dhe ruajtjen e dinjitetit njerëzor, përhapjen e pastërtisë në besim e moral, nxitjen e dijes dhe përhapjen e saj në mesin e kërkuesve të saj, mbrojtjen e të drejtave të individit dhe shoqërisë, ruajtjen e jetës dhe mbrojtjen e saj nga çdo gjë që e dëmton atë, lartësimin e pozitës së prindërve, gruas dhe farefisit, nxitjen e përkujdesjes për familjen dhe edukimin e fëmijëve, fitimin e hallallit dhe distancimin nga harami, etj.

TË DASHUR E TË SHTRENJTË,

Është koha që vlerat e besimit tonë t’i lexojmë e t’i kuptojmë si duhet, të vishemi me to, të angazhohemi për t’i përhapur në shoqëri me plot dinjitet dhe krenari, sepse në gjurmët e të parëve tanë do të ecim nëse duam të jetojmë me dinjitetin e qenies mëkëmbës të Zotit në tokë! E, nëse duam të shkojmë pas thirrjeve të propagandave të zhveshjes nga ky moral dhe ky shpirt, atëherë, le t’i lexojmë me të madhe ajetet vijuese: [E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kijametit do ta ringjall të verbër. Ai (që nuk besoi) do të thotë: “Zoti im, përse më ngrite të verbër, kur unë isha me sy?”. Ai (All-llahu) thotë: “Ashtu si i harrove ti argumentet Tona që t’i ofruam, ashtu je ti i harruar sot!”].⁹

(Hytbeja e mbajtur në xhaminë e Dërgutit, më 5 tetor 2018)

7. Ka prej atyre që thonë: Njeriu e krijon vetë fatin e vetit!

8. Imam Dhehebiu, vep. e cit., f. 248-251.

9. Kur’ani, Ta Ha: 124-126.

MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS: “SISTEMI YNË NË MARRËDHËNIE ME GJITHËSINË ËSHTË E MIRA!”



"Shko në shtëpinë tënde, foli me të mirë njerëzve të tu, buzëqesh në fytyrën e tyre! Ti po bën mirë!"

Nga minberi i xhamisë së fshatit Guci e Re, ku ishte të xhumanë, më 19 tetor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari ishte i qartë në mesazhin e dhënë nga minberi i kësaj xhamie: “All-llahu i Madhëruar urdhëron në suren El-Haxh: “Vepronjeni të mirën, që të triumfoni”. Vepronjeni të mirën, në trajtën e shquar, në të gjitha format, në të gjitha mënyrat, çdo ditë, çdo natë, pafundësisht!

“Vepronjeni të mirën”. Me ba mirë, me fol mirë, me pa mirë, me mendu mirë, me shku mirë, me u dëshmu për mirë! Dikush thotë: Unë nuk kam pasuri për të ba mirë! Jo! Nuk është në diskutim a ke, a nuk ke pasuri! Ti ke mendjen, ke gjuhën, ke syrin, ke veshin, ke zemrën, ke familjen, ke farefisin, ke shoqërinë, ke xhaminë, ke fshatin, ke qytetin, ke tokën ta punosh!

“Vepronjeni të mirën!”. Bëje të mirën në punën tënde, punoje mirë tokën tënde, sillu mirë në familjen tënde, shko mirë

me shoqërinë tënde, bëje një të mirë për xhaminë tënde; pastro diçka, jepi selam vëllezërve tuaj, jepi një gotë ujë një të moshuari! Shko në shtëpinë tënde, foli me të mirë njerëzve të tu, buzëqesh në fytyrën e tyre! Ti po bën mirë!

Me fjalë të tjera, All-llahu i Madhëruar po na tregon me këtë pjesë të vogël të këtij ajeti se, sistemi ynë në marrëdhënie me gjithësinë, me veten, me tjetrin, me Zotin para të gjithave, por edhe me vetë jetën, është e mira, o vëllezër!

Prandaj, teksa urdhërohemi për të bërë të mirën dhe e nxisim këtë në mesin e krejt shoqërisë, në të njëjtën kohë refuzojmë nga kushdo, në çdo kohë, në çdo vend e në çdo formë, që të na etiketojë ne me të kundërtën e asaj që urdhëron All-llahu i Madhëruar! Ne urdhërohemi për të vepruar të mirën, dikush na etiketon me të keqen, nuk shkon kjo! Nuk pranohet kjo, e refuzojmë këtë!”.



Shejkh Muhamed El-Gazali

Prej fatkeqësive, me të cilat jam ndeshur në rrugën e thirrjes, janë disa njerëz, që kanë dëshira të çmendura për vendime harami (ndalesash) në çdo gjë! Nëse do të kishin mundësi të ndalonin (bënin haram) ajrin, patjetër do të kishin dhënë fetva për këtë gjë, edhe nëse do të vdisnin të asfiksuar së bashku me njerëzit e tjerë.

Ata e imagjinojnë Islamit mesazh, që banon në globin e gjerë, në një lagje të ngushtë, e cila ka rregullat dhe traditat e saj; e që nuk lidhet me botën me asnjë të ndaluar, sido të jetë natyra e saj. E rëndësishme është, që lagjia e tyre të jetë vetëm për banorët e saj.

Të zotët e kësaj ideje, ndoshta mund të riparojnë dy dyer të kësaj zallamahie, por që të jenë thirrës të fesë botërore, që hap gjoksin për furtuna e shtete, që mishërohet me natyrën njerëzore të krijuar nga Allahu dhe mirëkuptohet me burrat dhe gratë, në Lindje dhe Perëndim, e gjitha kjo është e pamundur.

Kam parë prej tyre, që vështronin rrugën dhe fytyrat e tyre të mrrrolura. Duke qeshur i them: Çfarë të ka zemëruar?

Tha: Koka burrash të zbuluara, e gjithashtu edhe fytyrat dhe duart e grave dhe vaxhib (detyrë) është mbulimi i gjithë kësaj. Dorashka në dorë të gruas, nikabë në fytyrën e saj dhe çallmë ose kapuç në kokat e burrave. Kështu, me këtë gjë, shoqëria bëhet islame! Ai vazhdoi duke thënë: Në ihramin (veshjen) e Haxhit dhe të Umres, nuk ka mbulim koke, as nikabë në fytyrë dhe as dorashka në duar, por sa të mbarojnë ritet, gjendja ndryshon.

Nuk e pashë të arsyeshme të debatoj me këtë të mjerë dhe e konsiderova si një kalimtar që shpreh mendimin e një të rëndomtë, e që e pasojnë disa ekstremistë duke e konsideruar fe, por që nuk është fe. Derisa lexova fetvanë e një dijetari të madh, se mbulimi i duarve me dorashka është prej plotësimit të vaxhibit (obligimit)! Me këtë gjë, iu shtua edhe

FETVA FYESE!

një prangë tjetër lëvizjes së gruas dhe rrethit të të lejuarës, me të cilën e ka obliguar sheriatin.

Rishikova dijet e mia nga Libri i Allahut dhe suneti i të Dërguarit të Tij. Gjeta, se ato fjalë ishin mendime të veçanta të atij personi dhe nuk lejohet t'i quajmë fe, e as ngjashme me fenë!!

Gratë e takonin Pejgamberin dhe në gishtat e tyre mbanin unaza, e nuk i ndalonte nga kjo gjë, por vetëm i pyeste: A e kenë dhënë zekatin e tyre? Çfarë kuptimi ka shtimi i prangave artificiale ndaj gruas dhe shkaktimit iluzion tek besimtarët, se dora është avret dhe duhet mbuluar? A është qëllimi, shtimi i pengesave në rrugën e përhapjes së Islamit? Apo, është qëllimi t'i bëjë besimtarët të urrejnë Islamit dhe të ndjehen ngushtë me të?

Ebu Davudi dhe të tjerë transmetojnë, se Amër ibn Shuajb, ka transmetuar nga babai i tij, e ai nga gjyshi i tij, se një grua shkoi te Pejgamberi (a.s), e së bashku me të edhe vajza e saj. Në dorën e vajzës kishte dy byzlykë të trashë prej floriri dhe e pyeti: A e jep zekatin e tyre? Tha: Jo! I tha: A do të gëzohesh, që Allahu në ditën e kiametit të vishte me dy byzlykë prej zjarri? I hoqi nga duart dhe ia dha Pejgamberit (a.s) e i tha: Këto janë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij”.

Në transmetimin e Theubanit, në tregimin e Hind bint Hubejras, ajo kishte në dorë unaza të trasha dhe i Dërguari i qëllloi dorës së saj. Vazhdimësia e tregimit, na bën të ditur refuzimin e të Dërguarit të Allahut për atë shfaqje, e cila tregonte për mendjemadhësi dhe mburrje, e nuk tregonte aspak, as nga afër e as nga larg, se dora është avret!

Dijetarët janë të mendimit, se zemërimi i të Dërguarit ishte për mosdhënien e zekatin të atyre stolive dhe sikur ato ta kishin dhënë atë, ai nuk do të zemërohej prej tyre. Për këtë gjë, tregon edhe ajo çfarë transmeton Xhabir ibn Abdullah, duke thënë: “Kam qenë prezent me të Dërguarin e Allahun në namazin e Bajramit. Filloi me faljen e namazit përpara hytbes, pa ezan dhe pa ikamet. Pastaj, u ngrit duke u mbajtur për Bilalin dhe urdhëroi për përkushtim ndaj Allahut. Nxiti për bindje ndaj Tij, i këshilloi njerëzit dhe u përkujtoi atyre, pastaj vazhdoi, derisa arriti tek gratë dhe i këshilloi ato dhe u përkujtoi atyre duke thënë: Jepni sadaka, sepse shumica e juaj janë lëndë djegëse e xhehenemit! Nga mesi i grave u ngrit një grua me faqe të

kuqe në ezemere dhe tha: Përse, o i Dërguar i Allahut? Tha: “Sepse ju ankoheni shumë dhe mohoni të mirat (e burrit)”. Xhabiri tregon: Ato filluan të jepnin sadaka prej stolive të tyre, duke i hedhur në rrobën e Bilalit vathët dhe unazat”.

Hadithi, siç e shikon, tregon qartë se fytyra e femrës nuk është avret,

Prej fatkeqësive, me të cilat jam ndeshur në rrugën e thirrjes, janë disa njerëz, që kanë dëshira të çmendura për vendime harami (ndalesash) në çdo gjë! Nëse do të kishin mundësi të ndalonin (bënin haram) ajrin, patjetër do të kishin dhënë fetva për këtë gjë, edhe nëse do të vdisnin të asfiksuar së bashku me njerëzit e tjerë.

sepse atë e përshkruan transmetuesi pa asnjë problem. Dhe, në transmetimin e Buhariut thotë: “I shikoja duart e grave që i shtrinin në prehrin e Bilalit me stolitë e tyre”, pra dora nuk është avret.

I Dërguari ynë është dërguar me fenë e pastër tolerante dhe ua ka tërhequr vëmendjen për mjerim, atyre, që sjellin nga vetja e tyre probleme dhe vështirësi, duke thënë: “Janë shkatërruar ekstremistët”.

Sikur t'i ngarkonim femrat myslimane të veshin edhe dorashka, gjysma

e tyre do ta kishin të pamundur ta bënin një gjë të tillë dhe do ta kishin kundërshtuar.

Unë e pohoj, se i kam justifikuar disa ekstremistë, duke thënë: Njerëz të sinqertë që u mungon të kuptuarit në fenë e tyre, e sipas sinqeritetit që kanë i falet edhe injoranca e tyre, megjithëse kam filluar të ndjej shqetësim, se pas tyre mund të jetë dikush që e bën me qëllim vështirësimin e Islamit, në shërbim të nevojave të huaja!!

Islami përballet me rreziqe të mëdha në këtë kohë dhe tashmë jemi të bindur, se duar të huaja i thurin makinacione, ku me qëllim përhapin fetva fyese për devijues dhe llafazanë, derisa t'i largojnë pasuesit prej tij dhe t'i pengojë ata që hyjnë në të, e ky është rrezik i madh!!

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

Admir Plaku,
Imam - xhamia "Ebu Bekër"

Çdo haxhi ruan në kujtesë mbresa të pashlyeshme nga umreja apo haxhi i tij. Është në nderin tim të ndërr me ju disa nga mbresat e haxhit të sivjetshëm. Fillimin e mbresës sime për haxhin preferoj ta parashtroj duke thënë: “Pasha Allahun, haxhi! E ku e di ti se çfarë është haxhi”. E në të vërtetë duhet të prekësh me këmbë ato toka të shenjta që të shijosh kënaqësinë që të jep haxhi.

Ndjesia për haxhin fillon që në parapërgatitje. Këtë ndjesi fillova ta përjetoj menjëherë pas Ramazanit, megjithëse nuk kisha bërë nijet për haxh. Në fillim e pashë veten në ëndërr duke ecur në rrugë me një ndjesi turpi kur takoja njerëzit. (megjithëse nuk i vlerësoj shumë natyrën e tyre, më mbeti në mendje dhe më shtyu kureshtja të mësoj domethënien e saj). Lexova librin “Muaxhem të komentimit rreth ëndrrave”¹ dhe gjeta të shkruar se gjendja e besimtarit në ndalesat e haxhit është shenjë e kryerjes së tij. Pas kësaj iu riktheva leximit të librit të fikhut “Tuhfetul-Fukaha”² kapitullit të haxhit.

Nuk kaluan shumë ditë, njoftohem se nëpërmjet Komunitetit Musliman isha caktuar së bashku me 19 persona të tjerë (myftilerë e imamë, intelektualë) për haxh si “Miqtë e Mbretit”. Në fillim hezitova, mbeta i habitur nga gëzimi, por pastaj falënderova Allahun për këtë mirësi të madhe dhe në atë çast mu kujtua e çova rahmet hoxhës tone h. Vehbis S. Gavoçit, i cili thoshte: Ai vend i thërret vet njerëzit që do për umre e haxh.

Çdo udhëtim ka përgatitjen e vet, por udhëtimi për haxh është ndryshe. Udhëtim shprese për tu pastruar nga gjynahet dhe fituar xhenetin. Një mbresë e veçantë, e paharruar për çdo haxhi, është veshja e ihramit. Delikatesa e tij

1. Autorë: Ibën Sirin dhe Shejkh Abdulganij Nabulsi.

2. Alaudin Semerkan.

MBRESA TË PASHLYESHME HAXHI

e thjeshtë shpalos nijetin e besimtarit për të kryer umren apo haxhin. Finalizimi i veshjes së ihramit me të arritur në “mikate” tregon njëkohësisht kohën dhe vendin se ke hyrë në hapësirën e denjë për respekt. Që nga ai çast shqiptimi i himnit të haxhit “telbijes” është dominues kudo, kumbues dhe domethënës, derisa përpara teje shfaqet madhështore Qabja e madhnueshme. Madhështia e saj prek në zemër ndjenjën e besimit, pranë saj shpirti gjen qetësi sikur fëmija në kraharonin e nënës. Madhështia e saj bën, që nga syri i besimtarit vetvetiu të dalë lot i ngrohtë, gëzimi, dashurie e falenderimi ndaj Allahut.

Në hapësirën e saj ibadeti e lutja s`ka të mbaruar e as të specifikuar. Për atë që bën umren apo haxhin kënaqësia që të jep tavafi është e veçantë. Sado larg t'i qëndrosh Qabes gjatë tavafit, ajo të tërheq pranë vetes sikur dëshiron të thotë: Mos u largo, qëndro pranë meje. Fuqia e saj shpirtërore është magnet, tërheq pranë vetes besimtarët me lutjet e tyre, të ngjashme me ato që bëhen në ndalesat tek kodra e Safas dhe Merves.

Çdo gjë në Qabe për haxhiun është mbresë e paharrueshme dhe e bukur jo vetëm atëherë kur shokun që e ke në krah sa hap e mbyll sytë nuk arrin ta shohësh vetëm pasi ta kërkos, por edhe atëherë kur rrugët tejmbushen me besimtarë për të qenë të pranishëm në faljen e namazit të kohës apo kryerjen e obligimeve të tjera.

Rrugëtimi i haxhit është sakrificë, që besimtari e bën, qoftë gjatë qëndrimit në Mina, Arafat apo në Muzdelife. Çdo qëndrim në këto vende është i ngjashëm me “mahsher” pas “mahsheri” e në veçanti qëndrimi në Arafat. Vendi i shumëpëritur e emocionues, për të qenë i pranishëm në atmosferën e ibadetit e lutjes që ai vend të ofron.

Iu luta Allahut në gjuhë, i emocionuar, shpesh me lot që më dilnin vetvetiu, duke filluar nga vetja, familja, të afërmit, njerëz që më kishin lënë amanet që të lutesha për ta, e për vendin ku jetojmë.

Sabahu i pare i ditëve të “teshrikut”, kudo ka atmosferë, por në Mina mbetet i paharruar. Tekbiri, himni i këtyre ditëve, rrugë të tejmbushura me besimtarë që vinin në Mina për të gjuajtur shejtanin, duke sfiduar lodhjen, temperaturat e larta të të nxehtit, falja e namazit në xhaminë e Hifes, janë mbresa që nuk harrohen. Po ashtu, çdo lutje e përhëndetje me dorë e “Gurit të Zi” në tavafin e Lamtumirës të jep kënaqësi të madhe. Nga njëra anë, ai gur

regjistroj, e nga ana tjetër shpreson që të jesh prej atyre që u është pranuar haxhi.

Largohesh nga haremi i Qabes, por sytë të mbesin prapa me dëshirën për ta vizituar përsëri. Pastaj, rruga për në tokën e shenjtë të Tajbes, Medines, ecja përgjatë saj, është ecje në historinë e hixhretit. Histori e mbushur me sakrificën e besimtarëve, të cilët lanë gjurmë e që emrat e disa prej tyre i pashë të shkruar në muret e xhamisë së Pejgamberit (a.s). U gëzova shumë se më freskuan kujtesën e historisë së tyre, burra të përgëzuar me xhenet.

Vizita në qytetin e Medines zë një vend të veçantë. Tajjibe, qyteti i mirë e i shenjtë. Në mes të saj, fal deveve së udhëzuar të Pejgamberit, ndodhet xhamia

Çdo udhëtim ka përgatitjen e vet, por udhëtimi për haxh është ndryshe.

Udhëtim shprese për tu pastruar nga gjynahet dhe fituar xhenetin.

Një mbresë e veçantë, e paharruar për çdo haxhi, është veshja e ihramit.

e Pejgamberit (a.s), madhështore, e qetë me një frymë shpirtërore të veçantë, e pastër, model i mirëmbajtjes, mahnitëse, mikpritëse e ndërtuar me arkitekturë orientale. Nga kjo xhami nuk mund të mos lë pa përmendur kënaqësinë që më dha përhëndetja e Pejgamberit (a.s) me dy shokët e tij, Ebu Bekrin dhe Umerin (r.a) dhe falja e namazit në vendin e “Sufes”. Më ka mbetur si boshllëk mbrese, në këtë xhami kësaj here mos falja namaz në “Ruada”, kopsht të Pejgamberit (a.s). Mundësinë e saj nuk e neglizhova por fjala “shpejt, shpejt” e atyre që ruanin e shërbenin aty, më tingëllonte zhurmuese në vesh e aq më tepër në namaz.

Pjesë e vizitës ka qenë edhe mali i Uhudit, e vizituam por duke e pare nga autobuzi. Për mua kjo vizitë ishte mbresëlënëse, sepse boshllëkun e saj na e plotësoi vizita në xhaminë e Kubasë, xhami e mishëruar në devotshmëri.

Ditët kaluan shpejt. Çdo ditë në ato vende të shenjta janë të mbushura me kujtime të bukura. Lus Allahun që të na ketë pranuar haxhin e adhurimin tonë. Allahu ia mundësoftë secilit të bëjë haxhin e të jetë vizitor i vendeve të shenjta. Amin!

KUJTIME QË LIDHEN ME EMRIN E MADH TË DOKTOR BUTIT...

Gjatë viteve të studimit në Damask, në periudhën 1993-2001, përveç dijetarëve dhe edukatorëve të spikatur të shkollës sime, natyrshëm, kam ndjekur me shumë dëshirë përfitimi dhe me zellin e kërkuesit të dijes, edhe shumë e shumë dijetarë dhe eruditë të shquar të vendit, (kryesisht damaskenë, por edhe nga qytete të tjera siriane), nga derset dhe aktiviteti i të cilëve, Damasku ruante cilësinë e qytetit të ulemave dhe eulijave, që trashëgonin me dinjitet traditat më të përkryera të përhapjes së Thirrjes Islame nëpërmjet shembullit personal të dijetarëve punëtorë.

Dr. Muhammed Said Ramadan El-Buti, ishte padyshim njëri ndër këta dijetarë elitare, që tërhoqte përherë vëmendjen me ligjëratat, hytbet dhe librat e tij, sidomos atë të studentëve universitarë nga mbarë bota, që e ndiqnin kudo.

Ishte ajet prej ajeteve të dijes, modestisë, përkushtimit ndaj misionit të dijetarit elitare, elokucencës, saktësisë shkencore, forcës argumentuese, transparencës shpirtërore, tendencës për thyerjen e tabuve të trashëguara gabim, që duke iu ngjeshur Islamit, e kthenin atë në folklor popullor, më shumë sesa fé universale.

Herë pas here, me ndonjë prej shokëve të afërt, (a edhe vetëm), shkonim për ta falur namazin e sabahut në xhaminë e "Doktorit", siç qarkullonte në mesin tonë emri i tij. Ishte një rrugë me ngjitje drejt Kasijunit. Kalonte në mesin e shtëpive arabe, varrezës dhe një tatëpjete jo të fortë, derisa shfaqej xhamia.

Zakonisht, Doktorit falej imam.

Kishte një këndim të ëmbël, që e karakterizonte tingulli melankolik, që pa pyetur të depërtonte në shpirt e të ngacmonte ndjenjat e qëndrimit para duarve të Krijuesit të gjithësisë...

Pastaj vinte viridi i sabahut. Sa përshpirtje kishte në ato dhikre, synete të forta të transmetuara nga Resulullahu (a.s), që ia plotësonin vlerën dhe madhësinë namazit të parë të ditës së re...

I shumëpritur ishte momenti, kur të gjithë ngriheshin dhe krijohej një rresht i gjatë, që kalonin në qetësi drejt mihrabit, ku qëndronte i thjeshtë në madhësinë e tij, Dr. Buti... Momenti i shtrëngimit të duarve me zotininë e tij ishte emocion më vete. (Shpesh kthehej në objekt bisede dashamire në mesin e studentëve, që natyrshëm e donin dhe e vlerësonin tejmas mendimtarin e njohur, ezheristin e apasionuar pas shkencave të akaidit, filozofisë, (por jo vetëm), aty ku ylli i tij shkëlqente në qiellin e ymetit islam)...

Shpesh, mezi prisnim të vinte e xhumaja. Fillimisht, pasi ndiqnim dërsin e tefsirit të Hoxhës tonë, Shejkh Ahmed Keftaro, vraponim të dilnim nga xhamia dhe të ngjiteshim drejt xhamisë së Doktorit. (Ishte zhgënjim i madh për ne, kur ndonjëherë, për shkaqe udhëtimesh jashtë vendit, për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare kryesisht, Doktorit mungonte. Nuk dëgjohej njeri tjetër pos tij në minberin e tij. Nuk shijonte asnjë hytbe xhumaje në atë minber, pos hytbes së tij!)

Vraponim të zinim një vend përballë minberit. Prisnim me padurim momentin, kur Doktorit shfaqej në hyrje të sallës së faljes. Përherë i bënte me

shenjë njerëzve të mos ngriheshin në këmbë në shenjë respekti për të. (Po të ngriheshin, ulej dhe nuk e vazhdonte ecjen). Pastaj falja para ezanit të xhumasë dhe hytbeja e tij, që ishte fenomen më vete...

Dr. Buti ishte shkollë hatabeti (ligjërimi). Çdo hytbe kishte një bosht, që si vorbull të tërhoqte drejt thelbit dhe, të bënte të jetoje me të, ta ndjeje e të largoheshe nga xhamia duke medituar rreth përmbajtjes...

Shpesh, e ndalonte hytben e tij. I përfshirë në emocionet e ajeteve dhe haditheve të saj, si atë të xhuma, kur po përsëriste ajetin kur'anor 11 të sures Muhammed: "All-llahu është mbrojtës i atyre që besuan, kurse për jobesimtarët nuk ka mbrojtje!" E kujtoj si tani. Isha fiksuar në mimikën e fytyrës së tij. U mek, teksa lexonte këtë ajet të madhnueshëm...

Këto përshpirtje, e të tjera, më erdhën në mendje, teksa iu riktheva leximit të disa pjesëve nga libri i tij: "Personalitete që tërhoqën vëmendjen time", botim i vitit 1999, nga Shtëpia botuese prestigjioze damaskene, "Darul-Fikr". (Libri në fjalë trajton disa personalitete të shquara të ymetit islam, si: Abdull-llahu ibn El-Mubarek, Imam Ebu Hamid El-Gazali, Xhelaluddin Er-Rumi, Bediuzeman Said En-Nursi, Rozhe Garodi, Xhemaluddin El-Efgani etj, të cilët, Doktorit i analizon në një mënyrë jotradicionale, duke nxjerrë në pah tipare të mendimit, kontributit dhe prodhimtarisë së tyre intelektuale dhe shpirtërore, për t'u pasur zili.)

Rahmet pastë, sa boshllëk të madh ka lënë...

Imam Muhamed B. Sytari



ÇELËSA OPTIMIZMI

Rinisë çdo ditë e më shumë po i shteret vullneti dhe iniciativa për angazhim me studime, për punë, për jetë normale. Kjo, sepse ka pasiguri në shkollë, pasiguri në shëndetësi, pasiguri në punësim. Ata po dorëzohen më shpejt para vështirësive, kanë më pak sukses në shkollë dhe punë, bien në depresion më shpejt dhe sëmurën në mënyrë më të shpeshtë.

Kanë tendencë të shohin jetën me ankth dhe shqetësim, duke u përqendruar më shumë te vështirësitë, te mungesa e autoritetit të shtetit. Vjedhje dhe grabitje të të gjitha llojeve ka kudo, duke filluar nga agjencitë bankare, biznese, pika karburantesh, shtëpi etj. Kanasje, kërcënime dhe vrasje dëgjojmë e lexojmë çdo ditë. Llojet e drogave janë prezente në shkolla dhe në klube. Korrupsioni është prezent në të gjitha instancat.

Të rinjtë, zgjidhjen e kërkojnë tek emigrimi, i cili vazhdon që prej afër 30 viteve. Vendit tonë po i ikë Truri, po i ikin Përvoja dhe Kualifikimi, por edhe Krahu. Vetëm tek ne, njerëzit e mençur dhe të ndershëm janë të tepër.

Ilaçi i domosdoshëm dhe zgjidhja për këtë IKJE është ngjallja e optimizmi në mendjet dhe zemrat e të rinjve. Optimizmi rrezaton guxim e mençuri, gatishmëri për sakrificë dhe ndryshim pozitiv. Të menduarit dhe të vepruarit pozitivisht na e bën jetën më të shëndetshme dhe më të bukur.

"Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç'kanë në vetvete." (Er-Ra'd, 11)

Për ne, si besimtarë muslimanë, motivimin për angazhim produktiv e gjejmë te Besimi në Allah Fuqplotë, te Kurani i madhërishtëm, te modeli i Profetit Muhamed, alejhis-selam. Me anë të shtatë ajeteve kuranore dëshiroj të motivoj vëllezërit e mi për siguri, vendosmëri dhe besim në vetvete dhe besim te të tjerët. Shpresoj që këta 7

shkëndija hyjnore të jenë shkas për të reflektuar gëzim e gjallëri në jetë, në shkollë dhe në punë.

1. "Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësim! Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësim!" (Sherh, 5-6)

2. "Pas vështirësisë, Allahu sjell lehtësimin." (Et-Talak, 7)

3. "Mos u mërzit, se Allahu është vërtet me ne!" (Et-Teubeh, 40)

4. "Allahu, në të vërtetë, i mbron besimtarët." (El-Haxhxh, 38)

5. "... mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut!" (Ez-Zumer, 53)

6. "Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni, sepse ju, gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë." (Ali Imran, 139)


7. "... (duron!) sepse është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që Allahu në atë do t'ju sjellë shumë të mira." (En-Nisa, 19)

Të jesh i përkushtuar në studime, të bësh më shumë përpjekje në punë, të vlerësosh më tepër mundësitë dhe alternativat që posedon, të shpresosh në një rreze drite, ta shohësh të ardhmen plot shpresë, janë refleksione të nxitura nga këta ajete hyjnore.

Kushdo që i lexon dhe fillon të mendojë rreth tyre, e kupton se Allahu premtori ndihmë, mbrojtje dhe lehtësim pas çdo vështirësie. Duke e ditur këtë premtim hyjnor, ne vëmë re se humbja e shpresës, stresi që na ngërthen, ankthi që ndiejmë në çaste të vështira janë shenja të dobësisë së besimit tonë në Allah.

Meditimi rreth këtyre ajeteve ndihmon që të menduarit dhe të vepruarit pozitiv të jenë qëndrime mbizotëruese në jetën tonë, jo vetëm momentale. Çdo mendim, i mirë apo i keq qoftë, gjeneron dhe influencën një ndryshim fiziologjik në trupin tonë. Prandaj, mendo mirë dhe vepra drejtë, sepse do shpërblehesh mirë!

Neufel Kazazi



PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

"All-llahu i Madhëruar,

kur e krijoi gjithësinë,

shkroi me dorën e Tij,

për Veten e Tij.

Mëshira Ime e mund

zemërimin Tim!"

(Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh)

GJËMA (FATKEQËSIA) PALESTINEZE

Në vitin 1799, gjatë pushtimit francez të botës arabe, Napoloni lëshoi një shpallje nëpërmjet së cilës ai propozonte, apo ofronte Palestinën si një atdhe për hebrenjtë, nën mbrojtjen e Francës. Kjo ishte gjithashtu një mënyrë për të krijuar një prani franceze në rajon. Vizioni i Napolonit për një shtet hebre në Lindjen e Mesme nuk u realizua në atë kohë, por as nuk u shua. Në fund të shekullit të 19-të, plani u ringjall nga britanikët.

Pas rënies së Perandorisë Osmane, pas Luftës së Parë Botërore dhe krijimit të Mandatit të Palestinës, fuqia koloniale britanike filloi zbatimin e planit të saj për krijimin e një shteti hebre në tokën Palestineze. Në të njëjtën kohë, lëvizja sioniste po lobonte tek fuqitë perëndimore për të mbështetur migracionin masiv të hebrenjve në Palestinë dhe për të njohur pretendimin hebre për atë tokë.

Në vitin 1917, deklarata Balfour tregoi mbështetjen britanike për çështjen "atdhe për popullin hebre" në Palestinë. Deklarata u bë në një letër të shkruar nga sekretari i jashtëm i Britanisë asokohe, Arthur James Balfour, drejtuar Baron Rothschild-it, një udhëheqës i lëvizjes Sioniste Britanike. Letra u miratua nga kryeministri i atëhershëm i Britanisë, David Lloyd George, i cili vetë u kthye në sionist, në vitin 1915.

Letra deklaronte se britanikët "do të bënin sa kishin në dorë për të lehtësuar arritjen e këtij objekti". Për sionistët, kjo ishte një fitore e madhe.

Fluksi i sionistëve në Palestinë, i mbështetur nga britanikët, u ndesh nga rezistenca e ashpër palestineze. Blerjet e tokës nga hebrenjtë për të krijuar vendbanimet e sionistëve, bënë të zhvendosën dhjetëra mijëra palestinezë nga shtëpitë e tyre. I gjithë procesi u krye me ndihmën e britanikëve.

Ndërsa udhëheqja palestineze në Jeruzalem këmbëngulte në vazhdimin e negociatave me britanikët për të zgjidhur tensionet, Izudin El-Kasam, një udhëheqës sirian që jetonte në Palestinë (në Haifa) që nga viti 1922, filloi të bënte thirrje për një revoltë të armatosur kundër britanikëve dhe sionistëve.

Në vitin 1935, El-Kasam u rrethua nga forcat britanike dhe u vra së bashku me disa prej njerëzve të tij. Rezistenca e tij frymëzoi shumë palestinezë. Në vitin

1936, një rebelim arab shpërtheu kundër imperializmit britanik dhe kolonializmit sionist të Palestinës.

Në vitin 1939, britanikët e shtypën revoltën. Palestinezët e gjetën veten duke luftuar kundër dy forcave armike: forcat koloniale britanike dhe grupet e milicisë sioniste.

Megjithëse britanikët e kishin mbështetur emigracionin masiv hebre në Palestinë, fuqia koloniale filloi përpjekjet për ta kufizuar numrin e hebrenjve që



vinin në vend, në një përpjekje për të shuar trazirat arabe.

Kufizimi i ri që u vu emigracionit hebre në Palestinë i mërziti sionistët. Kështu, ata nisën një seri sulmesh terroriste ndaj autoriteteve britanike për t'i përzënë ata.

Sionistët nuk u ndalën, por vazhduan ta avancojnë më tej ëndrrën e tyre për krijimin e një shteti hebre në tokën palestineze. Ndërkohë, u bë e qartë se forcat e rezistencës palestineze ishin të pakta në numër dhe të paarmatosura.

Strategjia sioniste për të dëbuar palestinezët nga toka e tyre qe një proces i ngadalshëm dhe i paramenduar mirë. Sipas historianit izraelit Ilan Pappé, udhëheqësit sionistë dhe komandantët ushtarakë u takuan rregullisht, që nga marsi i vitit 1947 deri në mars të vitit 1948, kur finalizuan planet për pastrimin etnik të Palestinës.

Ndërsa sulmet sioniste ndaj britanikëve dhe arabëve u përshkallëzuan, britanikët vendosën ta dorëzojnë përgjegjësinë e tyre për Palestinën tek Kombet e Bashkuara të sapo themeluara asokohe.

Në Nëntor të vitit 1947, Asambleja e

Përgjithshme e OKB-së propozoi një plan për ndarjen e Palestinës në dy shtete: një shtet hebre dhe një shtet arab. Hebrenjtë në Palestinë përbënin vetëm një të tretën e popullsisë, shumica e të cilëve kishin ardhur nga Evropa vetëm pak vite më parë dhe kishin nën kontroll më pak se 5.5 % të Palestinës historike. Megjithatë, sipas propozimit të OKB-së, atyre iu dha 55 % të tokës. Palestinezët dhe aleatët e tyre arabë nuk e pranuan këtë propozim.

Lëvizja sioniste e pranoi propozimin që

OKB-së, me arsyetimin se ai legjitimonte idenë e një shteti hebre në tokën arabe. Por, ata nuk u pajtuan me kufijtë e propozuar dhe ndërmorën fushata për të pushtuar edhe më shumë tokë të Palestinës historike. Deri në fillim të vitit 1948, forcat sioniste kishin zaptuar dhjetëra fshatra dhe qytete, duke përzënë nga shtëpitë dhe tokat e tyre mijëra palestinezë, edhe pse mandati britanik ishte ende në fuqi. Në shumë raste, ata kryenin masakra të organizuara. Mesazhi i lëvizjes sioniste ishte i thjeshtë: palestinezët duhet ta lënë vendin e tyre ose të vriten.

Pasi që data 14 maj 1948, e caktuar nga britanikët për të përfunduar mandatin e tyre mbi Palestinën, po afronte, forcat sioniste i shtuan përpjekjet e tyre për të marrë tokat palestineze. Në prill të vitit 1948, sionistët zaptuan Haifën, një nga qytetet më të mëdha palestineze, dhe më pas ia vunë syrin Jafa-s. Në të njëjtën ditë, forcat britanike u tërhoqën zyrtarisht. David Ben-Gurion, atëherë kreu i Agjencisë Sioniste, shpalli krijimin e shtetit të Izraelit.

Brenda një nate, palestinezët mbetën pa shtet. Dy fuqitë e mëdha të botës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe

Bashkimi Sovjetik, e njohën menjëherë Izraelin.

Ndërsa, sionistët vazhduan fushatën e tyre të spastrimit etnik kundër palestinezëve, lufta shpërtheu midis vendeve fqinje arabe dhe shtetit të ri sionist. OKB-ja emëroi diplomatin suedez, Folke Bernadotte, si ndërmjetës të saj në Palestinë. Ai u njoh me gjendjen e vështirë të palestinezëve dhe u përpoq t'u jepte zgjidhje vuajtjeve të tyre. Përpjekjet e tij për një zgjidhje paqësore dhe për të ndaluar fushatën e vazhdueshme të spastrimit etnik përfunduan kur ai u vra nga sionistët, në shtator të vitit 1948.

Në vitin 1949, mbi 700 000 palestinezë u kthyen në refugjatë dhe më shumë se 13 000 prej tyre u vranë nga ushtria izraelite. OKB-ja vazhdonte përpjekjet për të arritur një marrëveshje armëpushimi midis Izraelit dhe vendeve arabe me të cilat Izraeli ishte në luftë.

Bernadotte, përfaqësuesi suedez i OKB-së në Palestinë, i cili u vra nga sionistët, u zëvendësua nga amerikanë Ralph Bunche. Negociatat e udhëhequra nga Bunche, mes Izraelit dhe shteteve arabe, rezultuan duke i dhënë shtetit të sapoformuar sionist edhe më shumë nga tokat palestineze. Në maj të vitit 1949, Izraeli u pranua në OKB, dhe grabitja e tij e mbi 78 % të tokave të Palestinës historike, u konsolidua. Pjesa e mbetur prej 22%, u bë e njohur si Bregu Perëndimor dhe Rripi i Gazës.

Ndërkohë, qindra mijëra refugjatë palestinezë mbetën në kampet e refugjatëve, duke pritur të ktheheshin në shtëpi.

Ndërsa lëvizja sioniste kishte synim kryesor dëbimin e palestinezëve nga toka e tyre, në të njëjtën kohë ajo u përpoq edhe t'i fshinte gjurmët e trashëgimisë dhe të kulturës palestineze. Objektivi i përgjithshëm i sionistëve nuk ishte asgjë më pak sesa një përpjekje për ta fshirë Palestinën nga harta e botës.

Gjëma palestineze nuk përfundoi në vitin 1948. Pastrimi etnik i Palestinës historike po ndodh akoma edhe sot dhe po kështu edhe rezistenca palestineze.

* * *

Allahu i Madhërishtëm thotë në suren El Isra': "I Madhëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhammedin) natën, nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t'i treguar atij nga shenjat Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.

Ne i dhamë Musait Librin dhe e bëmë

atë udhërrëfyes për bijtë e Izraelit (duke u thënë): "Mos merrni mbrojtës tjetër, përveç Meje!"

O pasardhës të atyre që Ne i mbartëm me Nuhun (dhe ju shpëtuam nga uji i detit siç shpëtuam Nuhin me besimtarët)... ai (Nuh) ka qenë vërtet një rob mirënjohës.

Ne u shpallëm solemnisht në Libër bijve të Izraelit: "Ju do të shkaktoni dy herë shkatërrime në tokë dhe do të tregoni arrogancë të tepërt. Dhe kur t'i vijë dita rastit të parë, Ne do të dërgojmë

Pas rënies së Perandorisë Osmane, pas Luftës së Parë Botërore dhe krijimit të Mandatit të Palestinës, fuqia koloniale britanike filloi zbatimin e planit të saj për krijimin e një shteti hebre në tokën Palestineze. Në të njëjtën kohë, lëvizja sioniste po lobonte tek fuqitë perëndimore për të mbështetur migracionin masiv të hebrenjve në Palestinë dhe për të njohur pretendimin hebre për atë tokë.

kundër jush robër Tanët, luftëtarë të fuqishëm, të cilët do të shkelin në çdo cep të shtëpive tuaja. Kështu, ky premtim do të përmbushet.

Pastaj, Ne do t'juja bëjmë të mundur juve sërish fitoren kundër tyre dhe do t'ju japim pasuri e djem, dhe do t'ju bëjmë të shumtë në numër.

Nëse bëni mirësi, e keni bërë për veten tuaj e, nëse bëni keq, prapë vetes ia bëni.

Dhe pastaj, do të vijë koha e përmbushjes së profecisë së dytë, që (armiqtë tuaj) t'juja nxijnë fytyrat tuaja dhe që të hyjnë në mesxhid, (në Jeruzalem), siç patën hyrë herën e parë, dhe që ta shkatërrojnë plotësisht çdo gjë që e keni bërë padrejtësisht!". (Kur'ani, El-Isra: 1-7)

Allahu i Madhërishtëm thotë më tej, në ajetet 103-104 të sures El-Isra: "Ai (Faraoni) deshi t'i dëbonte nga vendi, por Ne e fundosëm bashkë me të gjithë ata, që ishin me të. Pas kësaj, u thamë bijve të Izraelit: Vendosi në tokë dhe kur të arrijë moment i përmbushjes

së premtimit të dytë, do t'ju sjellim të gjithëve së bashku (të gjithë sa jeni dhe kudo që të jeni)".

Fjala "tokë" në këtë ajet ka ardhur në formë abstrakte, të pacaktuar se për cilën tokë bëhet fjalë.

Sipas dijetarit të njohur egjiptian, Esh-Sharavi, kjo fjalë tregon saktësinë e shprehjes së Kuranit Fisnik, sepse më pas jehuditë u shpërndanë nëpër gjithë anët e botës, pa patur një atdhe të tyrin që t'i mbledhë. Siç e tregon Kurani famëlartë kur thotë: "Dhe Ne i shpërndamë ata nëpër tokë, në popuj." – (Kur'ani, El-A'araf: 168)

Vetë realiteti e mbështet këtë. Jehuditë u shpërndanë në të gjitha vendet e botës dhe kudo që shkolin, veçoheshin në vende të caktuara ku ata mblidheshin, pa u përzier me njerëzit e tjerë. Gjen që çdo "copë" e tyre të jetë si një komb më vete, homogjen.

Ajeti: "Dhe kur të arrijë moment i përmbushjes së premtimit të dytë, do t'ju marrim të mbështjellë (të gjithë sa jeni)" – (Kur'ani, El-Isra: 104), premtimi i dytë këtu, është fjala për rastin e dytë të shkatërrimit dhe tiranisë që do të shkaktojnë jehuditë.

Ky shkatërrim i madh është ajo që ne po shohim tani, ku jehuditë janë mbledhur nga anët e anës, duke vrarë e përzënë palestinezët nga shtëpitë dhe nga toka e tyre. Ata po vijnë e mblidhen tashmë në një vend, për të realizuar premtimin e Zotit të Madhërishtëm kundër tyre.

Profeti i Zotit, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, ka lajmëruar për luftën që do të zhvillohet mes muslimanëve dhe jehudive, përpara së kjo botë të përfundojë së ekzistuar.

Transmetohet nga Ebu Hurejra se i Dërguari i Zotit, paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të, ka thënë: "Nuk do të vijë ora e përfundimit të kësaj bote, pa luftuar më parë muslimanët kundër jehudive. Muslimanët do të ushtrojnë presion të madh mbi jehuditë, derisa ata do të fshihen pas gurëve dhe pas pemëve, e gurët e pemët do të flasin e thonë: "O musliman, o rob i Zotit! Ja ku është një jehudi, këtu pas meje. Eja dhe vrite!" Përveç pemës Garkad (Nitraria) që është pema e jehudive." – (Muslimi)

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

Referenca:

<https://interactive.aljazeera.com>
<https://www.altafsir.com/Tafasir>

“EDUKONI FËMIJËT TUAJ ME DASHURI PËR PROFETIN MUHAMMED (A.S)” - DR. MUHAMMED A. JEMANI

(LIBËR I PËRKTHYER NGA H. VEHBİ S. GAVOÇI - SHKODËR, 1996)

NJË BURRË I MADH PREJ NJERIT NGA DY QYTETET

Mendjemadhësia dhe mburrja e ndalojnë njeriun për të parë të vërtetën, ia zënë sytë, madje e shtyjnë për dështim.

Këta lloj njerëzish as nuk mund të shohin të vërtetën, as nuk mund ta pasojnë. Prandaj një prej lutjeve më të vlershme të Profetit (a.s) ka qenë edhe kjo: “O Zot, na e kallëzo të drejtën të drejtë dhe na ndihmo ta pasojmë atë dhe të keqen të keqe dhe na ndihmo të largohemi prej saj.”

1. Shfaqja e madhësisë dhe e kryelartësisë është e vjetër. Ajo nis me fillimin e jetës së njeriut të parë. Sikurse përmendet në Kur’an, Zoti urdhëroi engjëjt (Me ta ishte edhe xhindi që adhuronte Zotin. Ky në fillim quhej pavodë e më vonë u quajt shejtan, që d.m.th.. i larguar). që t’i përuleshin Ademit duke rënë në sexhde. Të gjithë engjëjt zbatuan urdhrin e Zotit (xh.sh), përveç shejtanit. Ai, i mjeri, ngriti krye dhe refuzoi t’i përulej Ademit, madje tha: “Është gabim t’i përulem unë atij, jam më i mirë se ai.” Në këtë moment Zoti (xh.sh) e mallkoi shejtanin dhe e largoi nga mëshira e vet.

Zoti (xh.sh) në Kur’anin Famëlartë thotë: “Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoi një njeri nga balta dhe, kur ta kem përsosur atë dhe t’i kem dhënë nga ana Ime shpirt, ju menjëherë përulemi atij (në sexhde). Engjëjt, të gjithë së bashku iu përule, përveç Iblisit që ishte kryelartë dhe u bë prej jobesimtarëve. (Zoti) Tha: “O Iblis, çka të pengoi ty që t’i përulesh atij, që Unë vetë e krijova? A bëre kryeneçësi apo ke qenë prej atyre që shesin fodullëk?” Ai (Iblisi) tha: “Unë jam më i miri prej tij, mua më ke krijuar nga zjarri, e atë e krijove nga balta!” (Zoti) tha: “Dil pra prej tij (prej xhennetit), ti je i mallkuar dhe largimi prej mëshirës Sime ka për të përcjellë deri në ditën e gjykimit.” – (Kur’ani, Sad: 71-78)

Shejtanit e kuptoi mëkatit e madh që bëri, prandaj u përpoq qe Ademën me fëmijët e tij t’i largonte nga urdhrat e Zotit (xh.sh), që të ishin së bashku me të në zjarr. Madje u betua në fuqinë e Zotit (xh.sh) që të gënjejë njerëzimin për ta nxjerrë krejtësisht jashtë të mirave që i ruan Zoti (xh.sh).

Prandaj Zoti (xh.sh) na ndaluar

që të mashtrohemi prej tij dhe na ka kallëzuar se shejtani i thërret njerëzit, që edhe ata të jenë për në zjarrin e xhehenemit, nëse vazhdojnë rrugën e tij dhe zbatojnë këshillat e gabuara të tij. E për këtë Zoti (xh.sh) na ka ndaluar të jemi mendjemdhën, sepse ajo Madhështia i takon vetëm Zotit, për të cilin të gjitha krijesat kanë nevojë, ndërsa ai nuk ka nevojë për askënd. Në një hadith kudsî¹ thuhet: “Madhështia është për Mua, atë që mendjemadhësohet e thyej e s’kam gajle.” Ndërsa në një hadith të Profetit (a.s) thuhet: “Nuk hyn në xhenet ai që ka mendjemadhësi edhe sa një thërmi (atomi).”

Mendjemadhësia dhe mburrja e ndalojnë njeriun për të parë të vërtetën, ia zënë sytë, madje e shtyjnë për dështim.

Në këtë mënyrë sa e sa krerë të Kurejshitëve që njiheshin për urtësi e aftësi drejtuese, mendjemadhësia i ndaloi ata të mjerë për ta parë me sytë e tyre të drejtën dhe për ta ndjekur atë.

Ata, ndonëse e njihnin Profetin (a.s) si person besnik, që nuk gënjente kurrë as nuk vidhte kurrë, nuk pinte alkool, nuk u mor kurrë me gra për punë të liga, megjithatë i shtyu mendjemadhësia ta përgënjeshtroin Profetin në misionin për të cilin ishte dërguar e jo vetëm kaq, por edhe e morën për armik duke e luftuar dhe torturuar.

Ata e mohuan të drejtën duke e ditur atë dhe vazhduan në rrugë të shtrembër. Derisa pësuan, çka meritonin.

Ata e kanë ditur mirë madhësinë e Muhammedit (a.s) sjelljen e karakterin e tij, e kane ditur se ishte nga një familje e pastër dhe se nuk barazohej kush prej Kurejshitëve me Të dhe se familja e tij shërbente në Qaben e madhërueshme, nuk bënte asgjë të keqe me pasuesit e tij, siç bënin të tjerët, nuk sillej keq me të dobëtit. Prandaj ata prej mërisë

1. Hadith kudsî - janë fjalë të Profetit (a.s), shpjegime të tij, por kuptimi i tyre është dhënë prej Zotit (xh.sh). Kur’ani është fjala dhe kuptimi i Zotit.

thanë se do të ishte më mirë që Kur’ani t’i zbriste njerit prej dy burrave të mëdhenj të njerit prej dy qyteteve të mëdhenj, siç ishin: Urve në Taif dhe tjetri Velid, djali i Mugires në Mekë.

Lidhur me këtë mendim në Kur’an ka këtë përgjigje: “A iu takon atyre ta mësojnë Zotin se kujt t’ia japë Profecinë? Zoti di mirë kujt ia jep atë nder të madh.” – (Kur’ani, Ez-Zuhruf: 31-32)

Hoxha i madh, Bejhekiu, kallëzon: “Kalo një ditë Profeti (a.s) para Ebu Xhehlit dhe Ebu Sufjanit që ishin duke ndenjur. Ebu Xhehli i tha Ebu Sufjanit: “Ky është Profeti juaj, i një familjeje prej fisit tuaj? Ebu Sufjani iu përgjigj: “Pse po çuditësh, s’mund të jetë Profecia në familjen tonë? Ajo mund të jete edhe në familje me të ulët se e jona.” Ebu Xhehli i tha: “Çuditë se nga doli një djalë i ri ndërmjet jush si Profet!”

Profeti (a.s) i dëgjoi fjalët që po shkëmbenin ata, u afrua dhe i tha Ebu Sufjanit: “Ti nuk u hidhërove për hir të Zotit (xh.sh), por mbrojte fisin tënd.” Kurse Ebu Xhehli i tha: “Ndërsa ti, Ebu Xhehl, do të qeshësh pak e do të qash shumë.” Ebu Xhehli iu përgjigj: “Nuk është i mirë ky ultimatum që po më bën.

Vërtetë, erdhi dita dhe Ebu Sufjani e pranoi fenë islame ditën e fitores në Mekë, kurse Ebu Xhehli vazhdoi të jetë armiku më i egër i Islamit, saqë propozoi ta vrisnin Profetin (a.s) natën e emigrimit. Ebu Xhehli u vra më vonë në luftën e Bedrit.

Idhujtarët e shihnin Profetin (a.s) që rrinte me robër (sklevër) e me të vobektë, pa u interesuar se çfarë thonin të pasurit e tregtarët për prestigje e emra familjesh të mëdha që nuk pranonin të rrinin me të tjerët, veç me njerëz të sferës së tyre.

Zoti (xh.sh), i zbriti Profetit (a.s) ajetin që e urdhëronte të mos largonte nga vetja ata njerëz që luteshin natë e ditë për hir të Zotit (xh.sh), sepse ata janë të aftë për mëshirën e Tij.

Të mjerët ata, që gjendja në këtë jetë i shtyn të mohojnë Zotin (xh.sh) dhe Profetin e Tij (a.s) duke i sjellë vetes dhe pasuesve të tyre të ligë e zjarr.

Imam Ahmedi në librin e tij, ku ka përmbledhur 30.000 hadithe, kallëzon: “Kur u zbriti ajeti “Tërhiqja vëmendjen fisin tënd të afërt”², Profeti erdhi tek kodra

2. Kur’ani, Esh-Shuara: 214.

“Safa” afër Qabes së madhërueshme. U ngjit në kodër dhe thirri me zë të lartë, që të mblidheshin afër tij njerëzit. Kjo ishte hera e parë që ai Zotëri mbante një fjalim. Prandaj u tubuan aty shumë njerëz. Ai që nuk erdhi dot, dërgoi një zëvendës. Kur u grumbulluan para tij, filloi të flasë: “Ej, fisi i Abdulmuttalibit, ej fisi i Fihrit e i Kabit, po t’ju thoja se armiku është mbledhur në skaj të malit dhe do t’ju luftojë, a do të më besoni?”

I thanë: “Po, nuk dimë të na kesh gënjer ndonjëherë.”

Profeti (a.s) vazhdoi: “Pra, unë po ju them se jeni pranë një ndëshkimi shumë të ashpër.”

Ebu Lehebi u ngrit në këmbë e tha: “Këputsh qafen, a për këtë na ke mbledhur?” Atëherë u shpall kjo sure: “Qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi, e ai më është shkatërruar. Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet as ajo çka fitoi! Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë. Edhe gruaja e tij, ajo që barti dru (ferra), e në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur.” – (Kur’ani, El-Mesed: 1-5)

Ebu Xhehli qe armik shumë i egër i fesë islame, i Profetit (a.s) dhe i myslimanëve. Çfarë dëgjonte prej Kur’anit ia shtonte shurdhimin, çka shihte prej shenjave të drejta, ia shtonte verbërinë, çka dinte, e mësonte për bukurinë dhe saktësinë e fesë, ia shtonte errësirën e zemrës se tij. Prandaj meritoi të thirrej fraun i atij populli.

Njëherë ai pranoi se Kur’ani nuk është fjala e Muhammedit (a.s), por fjala e Zotit (xh.sh). Enesi me këtë rast pyeti: “Pra, mbasi e ditke se Kur’ani është i Zotit (xh.sh), d.m.th. se Muhammedi është i dërguari i tij. Ç’po bën, a po beson tani?”

Jo. Kurrë - u përgjigj ai i mjerë.

Një tjetër kryelartë që është sjellë keq me fenë islame, me myslimanët dhe me Profetin ka qenë Nadri, djali i Harithit.

Ibni Hishami kallëzon³: Nadri merrej me tregti dhe shkante në Hire, (Një vend arab nën Persinë e asaj kohe) ku mësoi disa përralla, magjinë e mbretërve dhe të parisë së shtetit, si: Isfen-djarin dhe Rrustemin.⁴

Qëllonte që, kur Profeti (a.s) mblidhte njerëzit dhe u lexonte Kur’anin, dilte Nadri dhe u thonte: “A e dëgjuat se ç’tha Muhammedi? Dëgjoni tani se çfarë them unë dhe fillonte me përrallat e gënjeshtat

3. Në librin: “Mbi historinë e Profetit (a.s).”

4. Dihet se, kur njerëzit largohen nga feja dhe barazohen me interesin, dalin shpifje e rregullohen gënjeshtër për të lavdëruar sundimtarët për fuqi, për drejtësi, për mëshirë e të tjera gjëra, që arrijnë t’i shfaqin me krime e tortura, por, kur rrezohet nga pushteti, del e vërteta në shesh.

Edhe sot njerëzit gënjehen nga drejtuesit kryelartë, nga pozita ose prestigji, nga mësuesi ose shoku, nga epshet e veset, ata gënjehen mbas tyre duke përbuzur të drejtën që u vjen nga njerëzit e pastër, të njohur për sjelljen e për karakter të lartë e jo nga pozita apo pasuria. Këto lloj njerëzish janë kudo në botë.

e tij.

Kur Profeti (a.s) triumfoi në Luftën e Bedrit, Nadri u zu rob e pastaj ai i mjerë e humbi këtë jetë dhe jetën e ardhme.

Një tjetër kryelartë, i cili duhet të bëhet shembull, që të mos gënjehemi, ishte edhe UKbe, djali i Muejtit. Ai ka qenë pasanik i njohur në Mekë. Njëherë, sa ishte në Mekë, Profeti (a.s) e vizitoi dhe i bëri thirrje të pranonte fenë islame. Ai e priti Profetin dhe i shtroi të hante. Por Profeti nuk pranoi ushqimin, derisa ai i mjerë të deklaronte: “Zoti është një dhe Muhammedi (a.s) është i dërguari i tij. “Mbasi e tha me gojë këtë fjalë të lartë, lajmi u përhap menjëherë në Mekë. Shoku i tij kryelartë, Umej-je, djali i Halefit, i doli një ditë para në rrugë dhe i tha: “Shiko, sa të holla do? “Ai iu përgjigj: “Jam pasanik dhe nuk kam nevojë për të holla.” Shoku i tij ia priti: “Jo, ke nevojë, përndryshe nuk do ta pranoje fenë islame.”

Shoku i tij nuk u mjaftua me kaq, por shtoi: “Në qoftë se ti je me të vërtete me ne, atëherë shko tek Muhammedi, refuzo fenë islame dhe pështyje.”

Shkoi ai i mjerë tek Profeti (a.s), mohoi besimin islam dhe e pështyu.

Për këtë problem Zoti (xh.sh) zbriti ajetin e mëposhtëm: “Atë ditë zullumqari do t’i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: “I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e të Dërguarit!” O shkatërrimi im! Ah, të mos kisha bërë filanin mik! Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej saj, e djalli është ai që njeriun e humb dhe e lë të vetmuar. E i Dërguari

tha: “O Zoti im, vërtetë, populli im e konsideroi këtë Kur’an, si (diç) të hedhur, (të hedhur pas shpine, e kanë braktisur). – (Kur’ani, El-Furkan: 27-30)

Edhe sot njerëzit gënjehen nga drejtuesit kryelartë, nga pozita ose prestigji, nga mësuesi ose shoku, nga epshet e veset, ata gënjehen mbas tyre duke përbuzur të drejtën që u vjen nga njerëzit e pastër, të njohur për sjelljen e për karakter të lartë e jo nga pozita apo pasuria. Këto lloj njerëzish janë kudo në botë.

Zoti (xh.sh) na kallëzon se ata njerëz të gënjer nga gjendja e mirë e tyre në këtë jetë, nuk mendojnë të ndjekin të drejtën, e cila del jashtë rrethit të tyre të kalbur. Zoti (xh.sh) tregon se jobesimtarët do të thonë të penduar ditën e amshimit: “Sikur të kishim dëgjuar dhe pasur mend, ne nuk do të ishim ndër banuesit e zjarrit.” – (Kur’ani, El-Mulk: 10)

Ata e pranojnë mëkatit, ata janë larg nga mëshira e Zotit (xh.sh), ku do të digjen përherë, pa iu lehtësuar vuajtja.

Deshi Zoti (xh.sh) që prej kryelartëve, pa shpirt e pa ndërgjegje, në Luftën e Bedrit të vriten 70 prej tyre. Kur u varrosen, Profeti (a.s) u afrua dhe u thirri: “O ju të varrosur, u sollët keq me mua, më përzutë nga vendi im! A e keni gjetur të vërtetën që u ka premtuar Zoti (xh.sh)? Një shok i tij i tha: “O i dërguari i Zotit, si u thërret njerëzve që sot janë kufoma dhe kundërmojnë erë të keqe? “Profeti (a.s) iu përgjigj duke thënë: “Ju nuk dëgjoni më mirë se ata, veçse ata nuk flasin e nuk përgjigjen.” – (Buhariu)

Kështu ata morën dënimin e merituar për krenarinë e tyre dhe korren, ç’ka kishin mbjellë prej madhësisë së tyre të plotë, megjithëse Kur’ani u zbrit në gjuhë të tyre e Profeti lindi dhe u rrit në vendin e tyre.

Sikur ta dinin atë nder të madh që u bëri Zoti (xh.sh), nuk do të ishin gënjer kurrë me sendet e kësaj bote, që shkojnë e vijnë. Mirëpo ata të mjerë bënë atë që bëri më përpara shejtani i mallkuar, i cili refuzoi t’i përulej Ademit, për të cilën gjë kishte urdhëruar Zoti (xh.sh).

I lutemi Zotit (xh.sh) që të përfitojmë nga ky rast e të jemi të përuar! Të jenë fëmijët tanë të modest dhe ta dinë se ai që përulet para Zotit (xh.sh), atë Zoti e ngre lart.

Të mësojmë vetë dhe të mësojmë edhe të tjerët me fjalë e me shembullin tonë që të jenë kryeulët, ashtu siç ka qenë jeta e Profetit (a.s), për të cilin Zoti (xh.sh) ka thënë: “Ti je me virtyte të larta”.

MYFTIU I SHKODRËS LIGJËROI NË CEREMONINË E XHAMISË SË RE NË TROISDORF

Me ftesë të kryesisë së xhamisë “Ebu Hanife” në Troisdorf të Gjermanisë, ditën e shtunë, më 29 shtator 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në ceremoninë e hedhjes së gurthemelit për ndërtimin e Qendrës së re Islame Shqiptare në këtë vend.

Gjatë fjalës së mbajtur, Myftiu falënderoi përkushtimin e shqiptarëve në këtë qytet, të cilët po japin një shembull shumë të mirë me fillimin e punimeve për një xhami të re me kompleksin e saj bashkëkohor, që e bën të jetë pikë referimi për muslimanët shqiptarë në Gjermani.

Sot, qyteti juaj i Troisdorfit, në të cilin jetoni dhe punoni si qytetarë legjitimë të këtij vendi mikpritës; ka festë dhe gëzon me gëzimin tuaj legjitim!

Toka e qielli sot, kanë bajram! Po nis punimet një XHAMI e re, ku të gjithë do të kenë një mundësi më shumë për të gjetur qetësinë e shpirtit, dritën e udhëzimit, fillin e arsyes dhe tërheqjen e zemrës drejt vlerave të besimit, drejt moralit dhe pastërtisë, drejt nxitjes për punë të ndershme dhe harmoni me tjetrin, drejt vëllazërimit dhe bashkëpunimit, drejt mbrojtjes dhe zhvillimit të paqes



sociale, drejt ruajtjes së identitetit islam dhe zhvillimit të harmonisë kombëtare, drejt ruajtjes së gjuhës tonë të bukur shqipe, me anën e së cilës do të mësojmë të madhërojmë Zotin e të lartësojmë mesazhin e Tij për mbarë njerëzimin: “O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek All-llahu, më i fismi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur nga të këqijat”], tha ndër të tjera Myftiu.

Me këtë rast, Myftiu uroi dhe falënderoi kryetarin e kryesisë së

xhamisë “Ebu Hanife”, H. Mahir Mustafa, imamin e saj, z. Resmi Likaj, si dhe bashkëpunëtorët e tyre të shumtë, që kanë dhënë dhe japin një kontribut shumë të madh për zhvillimin e aktivitetit fetar e kombëtar në Troisdorf, prej dekadash.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu vizitoi edhe xhaminë e re katedrale në zemër të qytetit të Këlnit, më e madhja xhami në Gjermani, që u inaugurua ditën e shtunë, më 29 shtator 2018, edhe me praninë e presidentit të Turqisë, z. Rexhep Taip Erdogan.

MYFTIU PRITI KRYETARIN E SHOQATËS SË MIQËSISË SHQIPËRI-VENDET ARABE

Paraditën e së martës, më 2 tetor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim prezantimi z. Muamer Vuci, Kryetar i Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Vendet Arabe.

Gjatë këtij takimi, Myftiu dëgjoji për aktivitetin e larmishëm të kësaj shoqate, që vepron në vendin tonë që në vitin 2000 dhe që ka në thelb të punës së saj krijimin e urave lidhëse ndërmjet popullit tonë dhe atij arab në fusha të ndryshme të jetës.

Njëkohësisht, u vu në pah aktiviteti i kësaj shoqate, sidomos në njohjen me vendet arabe dhe zhvillimet e fundit që kanë kthyer një pjesë të madhe të këtyre vendeve në qendër të vëmendjes së opinionit botëror.

Myftiu e falënderoi z. Vuci për vizitën dhe theksoi se është e domosdoshme që të nxirret në pah historia e gjatë e bashkëpunimit të popujve tanë, si dhe



kontributet e ndryshme të vendeve arabe në ndihmë të Shqipërisë dhe shqiptarëve, veçanërisht pas vitit 1990.

Ai tha se krijimi i urave lidhëse dhe hapja me vendet e botës arabe ka një dobi të madhe për vendin tonë, sidomos

në aspektin fetar, kulturor, ekonomik dhe përtej tyre.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për rrugët e bashkëpunimit në mes Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Vendet Arabe dhe Myftinisë Shkodër.

Mbrëmjen e së enjtes, më 4 tetor 2018, në kuadër të ligjëratave të përjavshme në xhamitë e Shkodrës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti dersin e tij të javës në xhaminë e Tophanës.

Në ligjëratën e kësaj mbrëmjeje, Myftiu u përqendrua edhe tek të drejtat e pjesëtarëve të familjes dhe gruas në veçanti, duke theksuar se në Islam secili individ dhe pjesëtar i familjes e gjen veten komod, rrethuar nga bekimet dhe përkujdesja hyjnore.

Ai tha se në jetën e Resull-llahut (a.s.) ka shembuj të shumtë të argëtimit në familje, përkujdesjes së theksuar ndaj bashkëshortes, të dëshmuarit i dobishëm dhe i ruajtjes së dinjitetit të familjes, edukimit të fëmijëve dhe kujdesit për ecurinë e tyre në jetë, etj.

Myftiu theksoi se: “Islami ynë, është

MYFTIU: “ISLAMI YNË ËSHTË BEKIM I PËRHERSHËM PËR JETËN E NJERIUT!”



bekim i përherëshëm për jetën e njeriut! Kudo ndër shekuj, kemi parë shembuj të mrekullueshëm të dëshmimit të kësaj mirësie që e merr njeriun për dore, për

ta nxjerrë nga batakut e errësirës në dritë, nga padija në urtësi dhe nga shkelja e të drejtave në bekimet e të drejtave të respektuara dhe lirisë së shëndoshë!”.

“PËRJETIME HAXHI”, ME HAXHILERËT SHKODRANË TË KËTJË VITI

Pasditën e së xhumasë, më 5 tetor 2018, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet kushtuar haxhilerëve të këtij viti. Si një traditë e përvitshme, ky takim u shoqërua me emocione të shumta, kujtime të paharruara dhe mbresa të veçanta nga të ftuarit.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, studiuesi islam nga Jordania, Dr. Xhemal Saferti, drejtori i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, z. Kujtim Dervishi, imamë të xhamive, intelektualë dhe miq të Myftinisë Shkodër, që nderuan haxhilerët me urimet dhe mesazhet e tyre.

Në fjalën e rastit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, pohoi se adhurimi i Haxhit të sivjetshëm ishte i mbushur me mesazhe, që e lidhin Shkodrën me vendet e shenjta, sikurse na nxisin të mendojmë për bekimet e mëdha me të cilat është rrethuar jeta e jonë në Islam.

Myftiu lajmëroi të pranishmit edhe për projektin e tij të ri për botimin e një libri me shënime dhe frymëzimet e këtij udhëtimi të paharruar të këtij viti.

Aktivitetin e përshëndetën edhe nënkryetari i KMSH-së, Myftiu i Malësisë së Madhe, Dr. Xhemal Saferti, teologu Lavdrim Hamja si dhe teologu Ruzhdi Plangaj, që dhanë mesazhe urimi dhe hodhën dritë mbi vlerën e madhe që ka Haxhi,



si njëra prej pesë shtyllave të fesë tonë.

Në mesazhet e tyre u vu theksi te ruajtja e shpirtit të Haxhit dhe dëshmimi i kësaj mirësie të madhe gjatë gjithë jetës, sidomos në marrëdhënie me njerëzit e afërm dhe shoqërinë.

Në një ligjëratë të posaçme, teologu Idmir Plaku, foli mbi emocionet dhe mbresat e tij nga Haxhi i sivjetshëm. Me

një gjuhë të pasur me dritë kujtimesh, ai dhuroi emocione të shumta, që e zbuluan këtë aktivitet me përmendjen e disa prej stacioneve kryesore të Haxhit 1439.

Në fund, për të pranishmit u shtrua një koktejl, ku të ftuarit patën mundësi të ndajnë me njëri-tjetrin kujtime dhe mbresa nga ky udhëtim i mrekullueshëm besimi.

PËRSHPIRTJE NGA HAXHI I SIVJETSHËM NË TV1 CHANNEL

Pasditën e së martës, më 8 tetor 2018, imamët e nderuar Idmir Plaku (xhamia "Ebu Bekër") dhe Adem Shahini (xhamia Perash) ishin të ftuarit nga Myftinia Shkodër, në emisionin: "Pasdite në Tv1 Channel" për të folur mbi eksperiencën e tyre dhe kujtimet e Haxhit të sivjetshëm.

Gjatë bashkëbisedimit, imamët e nderuar hodhën dritë mbi vlerat dhe pozitën e Haxhit, si një ndër pesë shtyllat e fesë islame. Njëkohësisht vunë theksin tek pozita e lartë e këtij adhurimi dhe shpërblimet që meriton ai që e kryen atë me përpikmëri dhe besim të patundur në mëshirën dhe bekimet e All-llahut.

Imamët thanë se është mirësi e madhe për Shkodrën dhe Shqipërinë, fakti që muslimanët e vendit tonë e kryejnë me rregull dhe përmallim të madh këtë adhurim të shtrenjtë.

Ata dhanë edhe përshtypjet dhe



emocionet e tyre të përjetuara gjatë Haxhit të sivjetshëm, ku patën mundësinë e madhe të ishin prej vizitorëve të Shtëpisë së shenjtë.

Të dy imamët vlerësuan tubimin e

mrekullueshëm të haxhilerëve nga mbarë bota si një moment kthese për mbarë botën dhe reflektim për kthimin e njeriut nga Zoti i tij, me pendim dhe në kërkim të mëshirës dhe faljes.

MYFTIU INSPEKTOI PUNIMET PËR KOMPLEKSIN ISLAM NË OBLIKË

Paraditën e të mërkurës, më 17 tetor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një inspektim në terren për të parë nga afër punimet që po bëhen për kompleksin e ri islam në fshatin Oblikë, Ana e Malit.

Prej kohësh, besimtarët e fshatit oblikë e kishin kërkuar një objekt shtesë për kryerjen e obligimeve fetare, si dhe për zhvillimin e natyrshëm të aktivitetit të rinisë.

Sot, falë Zotit, kjo ëndërr po bëhet realitet dhe po merr një pamje konkrete, që përveçse plotëson nevojat e kohës, zbulon krejt Anën e Malit, si një dëshmi e identitetit të saj shekullor!



SË SHPEJTI CIKLI I LIGJËRATAVE: "RESULULL-LLAHU (A.S.) SHEMBULLI MË I PËRSOSUR"



Paraditën e së mërkurës, më 24 tetor 2018, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, takoi disa prej imamëve të qytetit dhe fshatit, me të cilët ndau projekt-idenë e fillimit të një cikli të ri ligjëratash me temë: "Resulull-llahu (a.s.) – shembulli më i përsosur".

Myftiu shpjegoi se ky cikël nis pas diskutimeve dhe sugjerimeve të bëra nga imamët tñ, kryesisht të fshatrave, që kanë kërkuar më shumë aktivitete fetare, tubime e ligjërata për xhematin dhe banorët muslimanë të Qarkut Shkodër.

U lajmërua për idenë e këtyre tubimeve, si dhe imamët teologë që do të angazhohen në to. Njëkohësisht, u theksua rëndësia që kanë këto ligjërata në prag të fillimit të Muajit Rebiulevel

1440, në të cilin mbarë bota islame përkujton Lindjen e Begatë të Hz. Muhammedit (a.s.), të Dërguarit të All-llahut për mbarë botët.

Gjatë këtij takimi u vu theksi edhe tek domosdoshmëria e përzgjedhjes së tematikave dhe fjalorit me të cilin komunikojmë me njerëzit, qoftë në xhami, a në rrjetet sociale.



IMAMËT E SHKODRËS TUBOHEN NË MEXHLISIN E FIKHUT HANEFI

Pasditën e së mërkurës, më 3 tetor 2018, në xhaminë e "Dy Vajzave", vijoi tubimi i përjavshëm i imamëve të Myftinisë Shkodër, të cilët prej disa muajsh lexojnë bashkarisht librin "Çështje të fikhut sipas Kuduriut", nga Muhamed Ashik Ilahi El-Bureni, përkthyer në shqip nga i nderuari Sabri Bajgora, botuar në Prishtinë, 2009.

Tubimi në fjalë shërben më së miri edhe si një trajnim shkencor për imamët, sikurse i jep mundësinë e trajtimit të çështjeve të ndryshme që lidhen me adhurimet e përditshme, si dhe thellimin në dijen e shkollës juridike hanefite, të



cilës i përkasin muslimanët e trojeve shqiptare.

Tubimi në fjalë ka një dobi të madhe edhe për afrimin e imamëve me mexhliset e përbashkëta të dijes dhe shtimin e bashkëpunimit në mes tyre, si dhe dëshminë e përgjegjësive që mbajnë mbi supe si prijës të bashkimit dhe ruajtjes së besimit dhe fesë në shoqëri.

"RESULULL-LLAHU (A.S.) – SHEMBULLI MË I PËRSOSUR"

(Cikël ligjëratash në disa xhami të Shkodrës, 1 – 11 nëntor 2018)

Nr.	XHAMIA	DATA	LIGJËRUESI	KOHA
1	Shirokë	E Enjte - 1.11.2018	Lavdrim Hamja – Idmir Plaku	Pas akshamit
2	Bardhaj	E Xhuma - 2.11.2018	Adrian Uraj – Adil Cukali	Pas akshamit
3	Boks	E Shtunë - 3.11.2018	Naim Drijaj – Adem Pizga	Pas akshamit
4	Kullaj	E Diel - 4.11.2018	Gilman Kazazi – Naim Drijaj	Pas akshamit
5	Trush	E Hënë - 5.11.2018	Lavdrim Hamja – Ervil Kuçi	Pas akshamit
6	Barbullush	E Martë - 6.11.2018	Arben Halluni – Gilman Kazazi	Pas iqiindinsë
7	Bërdicë e Mesme	E Mërkurë - 7.11.2018	Lavdrim Hamja - Altin Nikshiqi	Pas akshamit
8	Kosmaç	E Enjte - 8.11.2018	Adem Pizga – Ervil Kuçi	Pas akshamit
9	Ganjollë	E Xhuma - 9.11.2018	Idmir Plaku – Lavdrim Hamja	Pas akshamit
10	Zues	E Shtunë - 10.11.2018	Ervil Kuçi – Idmir Plaku	Pas akshamit
11	Shtoj i Vjetër	E Diel - 11.11.2018	Adrian Uraj – Durim Kasemi	Pas akshamit

Ditën e xhuma, më 26 tetor 2018, nga minberi i xhamisë së fshatit Shirq, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, u përqendrua tek mesazhi i afrimit me thirrjet e besimit dhe distancimi nga shturrja në besim e moral.

Myftiu theksoi se, përtej thirrjeve të disave me pushtet të përkohshëm, që ju thonë se shqiptarët e kanë në gen laicizmin, të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm se njeriu, si krijesë e Zotit Një, ka në gen besimin dhe lehtësimin e udhëzimit drejt dritës së Atij, që e ka krijuar!

Afetarizmi dhe shpallja e luftës ndaj Zotit, i dha pasojat e veta ndër shqiptarë, rezultatet dëshpëruese dhe shkatërruese të së cilës i përjetojmë edhe sot në shumë drejtime të jetës në vendin tonë! – tha ndër të tjera.

Myftiu foli edhe për rrugët e larsimit të njeriut besimtar drejt fitimit të dashurisë dhe mëshirës së All-llahut, nëpërmjet korrektësisë me atë që ka shpallur dhe legjitimuar Vetë Zoti i

MYFTIU: “JEMI FTUAR TË JETOJMË SI EULIJA TË ALL-LLAHUT!”



gjithësisë në Kur'an, si dhe nëpërmjet respektimit dhe pasimit të shembullit të përkryer të Hz. Muhammedit (a.s.).

“Jemi ftuar të jetojmë si eulija të All-llahut, pasues dhe përhapës të Dritës

së Tij, në harmoni me Zotin, njeriun, familjen, punën, dijen, komshiu, tjetrin, kushdo qoftë ai! Jemi ftuar të jetojmë në vëllazërinë e madhe të qenies tonë Njerëz!”, udhëzoi Myftiu në hytben e tij.

PËR TË MOS HARRUAR DATAT TONA TË SHËNUARA!

(23 VJET XHAMIA E RE E FUSHË ÇELËS, “EBU BEKËR”)

Më 27 tetor 1995, në qytetin e Shkodrës, u inaugurua Xhamia e Madhe e Fushë Çelës, që u zbulua me emrin e sahabiut të dashur, Hz. Ebu Bekër (All-llahu qoftë i kënaqur prej tij).

Xhamia u ringrit mbi vakëfin e vjetër, dhuruar dekada më parë nga i nderuari Çelë Zylyftari, rahmet pastë.

Xhamia aktuale është kontribut i familjes saudite Ez-Zamil, All-llahu i shpërbleftë me mirësitë dhe bekimet e tij.

Disa prej imamëve, vaizëve dhe hatibëve që kanë shërbyer dhe vazhdojnë të kontribuojnë për këtë xhami të re, nga dita e inaugurimit dhe deri sot, në përvjetorin e saj të 23-të:

H. Faik Hoxha, Mr. Muhidin Ahmeti, Hfz. Etem Haliti, teologu Sokol Mandi, teologu Ylli Buraniqi, Imam Ndrichim Sulejmani, teologu Idmir Plaku, teologu Gilman Kazazi, teologu Altin Nikshiqi, etj.

Mirënjohje dhe respekt për imamët tanë të dashur, besimtarët frekuentues dhe kontribuuesit për mirëmbajtjen dhe gjallërimin e kësaj xhamie, pjesë e pandarë e pasaportës së qytetit tonë!



MEJTEPI I IM... XHAMIA E FSHATIT URA E SHTREJTË

PAK HISTORI:

- Xhamia e fshatit Ura e Shtrenjtë ndodhet në njësinë administrative “Postribë”, bashkia Shkodër. Përbëhet prej 55 familjeve myslimane, 15 fise, më 250 banorë, të ndara në 8 lagje.

- Xhamia ekzistuese është ndërtuar para 300 viteve. Pas rilejimit të lirisë së besimit në vendin tonë, i është nënshtruar rikonstruksionit në vitet 1993 dhe në 2002.

- Në këtë xhami nga viti 1993 e deri më tani kanë shërbyer shumë imamë dhe mësues të mësim - besimit islam: Ilir Ndrejaj, Kujtim Cufaj, Nexhmi Bejtja, Agim Braqi, Shkëlqim Sykaj, Selim Sykaj, Sherif Jahja dhe Samed Mataj.



mësimet e vërteta fetare, edukatën dhe moralin islam që duhet të ketë çdo besimtar, duke u mbështetur te tradita, fryma e mirë paqësore, harmonia dhe sjellja e mirë me të gjithë krijesat e Zotit (xh.sh).

Më pas, përgjegjësi i arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi aktual z. Samed Mataj.

Gjithashtu, teologu Arben Halluni diskutoi me imamin edhe për nevojat që ka xhamia për mirëmbajtjen e këtyre aktiviteteve mjaft të rëndësishme arsimore dhe edukative.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar 7 kurse të ndryshme fetare të zhvilluara në xhami nga viti 2002 - 2018 është rreth 130 djem dhe vajza.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në kuadrin e vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë mejtepet për kurset e mësim besimit, përgjegjësi i tij, teologu Arben Halluni zhvilloi të xhumanë, më 26.10.2018 një takim me nxënësit e xhamisë së fshatit Ura e Shtrenjtë.

Në fillim, ai mbajti një bisedë me nxënësit e xhamisë, duke u folur atyre për rëndësinë që ka organizimi i mejtepeve dhe i kurseve fetare pranë xhamive, për misionin që mbartin ato, më qëllim për të përçarur te brezi i ri



Mbërritja e librit të Kur'anit më të çuditshëm në botë në Medinën e Pejgamberit (a.s) është bërë lajm botëror, për shkak se, ky Kur'an nuk është i shkruar me penë, as me bojë dhe as me laps!

Një grua besimtare nga Pakistani (krahina Panxhab), mori përsipër ta shkruajë Kur'anin në metodën e qëndisjes. Dhe filloi me qëndisjen e tij në vitin 1987 dhe mbaroi në vitin 2018.

Gruaja ishte betuar në veten e saj që do ta qëndiste këtë Kur'an, çdo shkronjë të tij, vetëm atëherë kur ajo të ishte në pastërti të plotë dhe gjithashtu, që të mos qëndisë asnjë shkronjë nga Kur'ani vetëm atëherë kur ajo të ishte në pjesën e fundit të natës (afër sabahut).

Iu deshën plot 31 vite për të shkruar librin e Zotit me metodën e qëndisjes.

Zonja Nessim Akhtar ia dhuroi këtë libër Kur'ani muzeut të Kur'anit Famëllartë në Medinën e Ndrichuar në sezonin e Haxhit 1439, i cili pasi u

KUR'ANI MË I ÇUDITSHËM NË BOTË



verifikua në detaj u vendos në këtë muze.

E mbuluar nga emocionet, ajo deklaroi se ishte e lumtur dhe e nderuar

për këtë mirësi të madhe që ebeigatoj jetën e saj.

(Përktheu: Ervil Kuçi)

MYSLIMANËT E SHBA-SË NDIHOJNË FAMILJET E VIKTIMAVE TË SULMIT NË SINAGOGË

Myslimanët në SHBA kanë dënuar sulmin e së shtunës mbi sinagogën në Pittsburgh dhe nisën një fushatë për të ndihmuar familjet e viktimave.

Myslimanët në SHBA kanë dënuar sulmin e së shtunës mbi sinagogën në Pittsburgh dhe nisën një fushatë për të ndihmuar familjet e viktimave.

Këshilli i Organizatave Myslimane në SHBA (USCMO) dhe Këshilli për Çështje Amerikane-Islame (CAIR) kanë reaguar për sulmin në fjalë.

“Shprehim ngushëllimet tona të sinqerta për familjet e të pësuarve. Dëshirojmë të theksojmë se të plagosurit dhe komuniteti hebre, i cili u trondit nga ky lajm i keq janë në lutjet tona”, thuhet në reagimin e USCMOS-s.

Vrasjet i ka dënuar edhe Safdar Khwaja nga CAIR, i cili sulmin e quajti qyqar, për të shtuar se sulmi mbi sinagogën të cilën e kanë vizituar edhe vet ata, është tmerrsisht shqetësues.

“Ky aktivitet terrorist po na prek të gjithëve. Dera jonë mbetet gjithmonë e hapur për fqinjët tanë të cilët po kalojnë nëpër këtë tragjedi, për çka u shprehim mbështetjen tonë të plotë”, tha Khwaja.

Ai thotë se bëhet fjalë për një sulm mbi vlerat amerikane dhe parimet njerëzore, duke shtuar se, “Patjetër të bëhemi

Muslims Unite for Pittsburgh Synagogue

Donate to Shooting Victims' Families

LaunchGood.com/Synagogue >>



bashkë, në mënyrë që shoqërisë sonë t'ia kthejmë vlerat civilizuese. U bëjmë thirrje të gjithë zyrtarëve, që të nxjerrin para drejtësisë fajtorët për këtë sulm”.

Ndërkohë, shumë myslimanë në Amerikë i'u bashkuan fushatës “Myslimanët janë të bashkuar për viktimat e sulmit të sinagogës në Pittsburgh”, qëllimi i së cilës është mbledhja e fondeve për familjet e të pësuarve.

Fondi prej 25.000 dollarë, që ishte qëllimi i fushatës u mbledh për vetëm

gjashtë orë dhe deri më tani është mbledhur një shumë prej 75.000 dollarë.

“Në myslimanët amerikanë, zgjasim dorën e ndihmës për familjet e të vrarëve dhe të plagosurve në sulm. Dërgojmë mesazhin e mëshirës, që të keqen ta luftojmë me të mirë, ashtu siç na mëson feja jonë”, thuhet në ueb faqen e fushatës.

Në sulmin të cilin e kreu shtetas amerikan Robert Bowers (46), vdiqën 11 persona dhe gjashtë të tjerë u plagosën.

Nga të plagosurit, katër janë policë.

(radiojehona.al)

KONTRIBUTI I SHTETIT OSMAN NË INFRASTRUKTURËN E RRUGËVE TOKËSORE NË BALLKAN

Perandoria Osmane, e cila hyri në një obligim të madh financiar, në rajonin e Ballkanit ndërtoi linja hekurudhore në gjatësi 2.512km.

Rrugët në Ballkan, ashtu si në çdo vend të rruzullit tokësor, me shekuj mbetën në atë mënyrë siç i ofroi natyra apo në një formë të ngjashme. Në anën tjetër drejtimi i rrugëve u përcaktua edhe nga ana e shteteve nën sovranitetin e të cilëve ishin ato po aq sa nga vet natyra. Me kalimin e Ballkanit në administrimin e Shtetit Osmanë, ky rajon hyri në një proces kur u zhvilluan rrugët dhe qytetet, u rregulluan kushtet e jetesës dhe ku rendi shoqëror e jeta sociale pësuan ndryshime të mëdha. Ashtu siç thotë historiani i njohur turk, Ilber Ortaylı Perandoria Osmane ka bërë më shumë investime në Ballkan se sa në Anadoll.

Me marrjen e Kalasë Çimpi në afërsi të Galipolit në vitin 1352, Perandoria Osmane hodhi edhe hapat e para në Ballkan. Kjo u pasua nga një periudhë 350-vjeçare e përparimit të osmanlinjve drejt Evropës Qendrore. Në qytetet ballkanase, të cilat kaluan nën administrimin e osmanlinjve, u ndërtuan rrjetet e ujësjellësit, çezma, banja turke, biblioteka e ura, ndërsa u jetua një zhvillim kulturor.

Ndërkohë që osmanlinjtë zhvillonin sistemin rrugor të tyre, ata përfituan në masë të madhe nga rrugët e mbetura nga periudha mesjetare. Edhe rruga tokësore, e cila lidhë Stambollin me Beogradin nëpërmjet Sofjes, gjatë periudhës osmane shërbeu si linjë kryesore e transportit. Kështu që osmanlinjtë këtë rrugë të quajtur “Orta Kol” (Dega e mesme) u përpoqën ta mbajnë më mirë në krahasim me rrugët tjera për shkak të rëndësisë ushtarake dhe tregtare që kishte ajo.

Edhe rruga “Via Egnatia” e ndërtuar nga romakët, e cila shtrihet prej Durrësit ose Vlorës në Shqipëri e deri Stamboll nëpërmjet Selanikut, është përdorur nga ana e osmanlinjve me disa ndryshime të bëra, ndërsa u quajti “Sol Kol” (Dega e majtë). Ndërkaq rruga e quajtur “Sag Kol” (Dega e djathtë) e cila lidhë Stambollin me Krimenë dhe që shtrihet përgjatë brigjeve perëndimore të Detit të Zi, nuk ishte edhe aq aktive nga aspekti ushtarak, por luajti një rol të rëndësishëm në transportin e mallrave si grurë, mish dhe kripë për në Stamboll.

Krahas marrjes nën kontroll dhe përdorimit të rrugëve të mbetura nga

periudha antike dhe ajo mesjetare, osmanlinjtë kanë ndërtuar edhe rrugë të reja dhe riparuan rrugët e vjetra në bazë të nevojave të tyre. Ndërsa për të lehtësuar transportin osmanlinjtë përgjatë rrugëve kryesore ndërtuan edhe bujtina. Më vonë gjatë periudhës së administrimit të osmanlinjve në Ballkan veçanërisht në shekullin e 18-të dhe 19-të, relativisht u zvogëluar edhe rëndësia që i kushtohej rrugëve tokësore.

Duke filluar nga shekulli i 19-të udhëheqësit osmanë treguan më shumë interesim në ndërtimin e linjave hekurudhore në Ballkan. Osmanlinjtë kishin nevojë për këto linja për të ruajtur rendin dhe qetësinë në rajonet e largëta dhe në këtë mënyrë të ruajnë edhe tërësinë territoriale të vendit. Përveç arsyeve ushtarake dhe të sigurisë, në saje

Rusçuk dhe Varna në Bullgari që ishte e gjatë 224km. Në saje të këtyre linjave lumi Danub dhe Deti i Zi u lidhën me njëri-tjetrin me linja hekurudhore dhe në këtë mënyrë u zgjidh edhe problemi i transportit që jetohej në 241 kilometrat e fundit të lumit Danub.

Linja më e gjatë hekurudhore në Ballkan e ndërtuar nga ana e osmanlinjve është linja lindore. Më 17 prill të vitit 1869 mes bankierit nga Munihi, Mority von Hirsch dhe qeverisë së osmanlinjve u nënshkrua një marrëveshje për ndërtimin e linjës hekurudhore që do të lidhte Stambollin me Vjenën. Mirëpo marrëveshja origjinale e nënshkruar mes Hirsch dhe osmanlinjve ka ndryshuar për shkaqe të ndryshme.

Një zhvillim i rëndësishëm që mundësoi përfundimin e linjës lindore të hekurudhës ishte Kongresi i Berlinit i mbajtur më 13 korrik 1878. Kongresi i Berlinit, i cili riorganizoi hartën e Ballkanit në mënyrë për të siguruar stabilitetin në rajon të fuqive të mëdha, krijoi edhe mundësi për të siguruar detyrime financiare të projekteve të linjave hekurudhore në Serbi, Rumania dhe Bullgari. Posaçërisht Serbia dhe Bullgaria u mbajtën përgjegjëse për të ndërtuar



të këtyre linjave do të lehtësohej edhe hapja në botë nëpërmjet porteve detare të sektorit osmanë të bujqësisë, ndërsa besohej se do të rriten edhe të ardhurat nga taksat që do të mblihdeshin nga tregtia e jashtme dhe taksat doganore.

Për shkak të pamjaftueshmërisë financiare, një pjesë e madhe e linjave hekurudhore të osmanlinjve në Ballkan u ndërtuan me anë të kapitalit të huaj me sistemin e “garancës për kilometër”. Kjo garancë ishte një qasje e zhvilluar për të nxitur kapitalin e huaj për të investuar. Sipas kësaj shteti kompanisë, e cila ndërton linjën hekurudhore, i garantonte norma minimale të të ardhurave për kilometër.

Linja e parë hekurudhore e ndërtuar nga osmanlinjtë në Ballkan është ajo e ndërtuar në vitin 1860 që lidhte qytet Konstanca dhe Cernavoda të Rumanisë së sotme dhe ishte e gjatë 66km. Gjashtë muaj pas ndërtimit të kësaj linje u përrua edhe linja tjetër që lidhte qytetet

linjat hekurudhore në territore të tyre që do të lidhnin linjat hekurudhore të Perandorisë Austro-Hungareze me ato të Perandorisë Osmane.

Si përfundim u ndërtua edhe linja lindore dhe më 12 gusht 1888 nga Vjena u nis treni i parë në drejtim të Stambollit. Në saje të linjës lindore të hekurudhës mes Stambollit dhe Beogradit, kohëzgjatja e udhëtimit që zgjaste 10 ditë nëpërmjet rrugëve tokësore, u ulë në 30 orë. Ndërkaq koha e udhëtimit mes Parisit dhe Stambollit që kanë një distancë 2.897km u ulë në 96 orë.

Perandoria Osmane, e cila hyri në një obligim të madh financiar, në rajonin e Ballkanit ndërtoi linja hekurudhore në gjatësi 2.512km. Ndërsa pas pavarësisë së vendeve të Ballkanit nga linjat në fjalë osmanlinjve ju mbeti vetëm një borxh i madh.

Dr. Erhan Turbedar

(www.trt.net.tr/shqip)




I DËRGUARI I ALL-LLAHUT (A.S),
MËSHIRË PËR TANËSINË,
HZ. MUHAMMED (A.S) - (570 - 632)

19 nëntor 2018, përkujtimi i lindjes së Pejgamberit (a.s)

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

**“Më të mirët ndër ju janë më të mirët
me familjen e tyre”**

**“Më i miri i njerëzve
është më i dobishmi i tyre për njerëzit”**



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtuës:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org